



**BULETINI MUJOR I  
SEMUNDSHMERISE  
INFEKTIVE**

(Pasqyra 14 Sh)

**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË  
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

MAJ, 2019

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejances dhe Shërbimit të Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 të çdo muaji. Te dhënat e agreguara të pasqyrës 14 sh për muajin maj janë të dhënat e raportuara nga të NJVKSH në rrethe.

### 1. Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjate muajit maj 2019 zënë 31.06 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me ane të Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidencë 213.78/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohe që në nivel kombëtar toksikoinfeksionet alimentare paraqesin një incidencë 3.75/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Kukës dhe Kavajë mbajnë peshën kryesore në raportimin e toksikoinfeksioneve alimentare. Duhet theksuar që numri i lartë i rasteve të raportuara me toksikoinfeksione alimentare dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rrethëve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike

Rrethi i Shkodrës vazhdon të mbajë peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës jotifoide për muajin maj 2019 me 22 raste (1.32/10.000 banore) të konfirmuara dhe ndjekur nga rrethi i Dibrës me katër raste Salmoneloze jotifoide të dyshuara klinikisht. Janë raportuar 20 raste me Shigeloze, përkatësisht 14 raste (0.84/10.000 banore) nga rrethi Shkodër, tre raste nga Lezha dhe përkatësisht nga 1 rast kanë raportuar rrethet Tirane, Vlore dhe Librazhd.

Gjate muajit maj është raportuar nga rrethi i Tiranës një rast me diagnozë Tifo abdominale, femër 48 vjeç banore e Alliasit, e shtruar dhe e konfirmuar në QSUT, “Reparti i Infektivit”. NJVKSH Tirane ka marrë të gjitha masat përkatëse.

**Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin Maj, 2019**

(Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Maj 2019	Incidenca Maj 2019 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	1	0.04


Salmoneloza	27	0.96
Shigeloze (Disenteri bacilare)	20	0.71
Dizenteri amebike	0	0
Toksikoinfeksione alimentare	105	3.75
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	5833	208.31
Semundje diarreike ne total	5986	213.78


## 2. Sëmundjet e EPI

### 2.1. Fruthi

Gjatë muajit maj 2019 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë dyshuar në total 89 raste prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv 42 raste. Nga këto 15 raste (36%) e rasteve i përkasin rrethit të Tiranës dhe 9 raste (22%) rrethit të Gjirokastrës.

31% e rasteve të konfirmuara i përkasin kryesisht grupmoshës < 2 vjeç (13 raste). Gjatë muajit Maj vërehet një rënie e rasteve me fruth. Një informacion më të zgjeruar ju mund ta gjeni në “Buletinin Javor të Fruthit”, në website të ISHP.



**Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve te dyshuara për fruth sipas datës se fillimit te rashit, Maj 2019****Grafiku 2. Kurba epidemike e rasteve te dyshuara për fruth sipas datës se fillimit te rashit, Maj 2018**

Ne muajin Maj te nje viti me pare, 2018 u raportuan ne total 438 raste prej te vileve 217 u konfirmuan nga ana laboratorike . Nga keto raste ose 60 % (129 raste) i perkisnin rrethit te Tiranës. 21.2% ose 46 raste i perkisnin grupmoshes nen 2 vjec dhe 16-20 vjec secila.

Siç shihet ne krahasim për te njëjtën periudhë me një vit me pare, numri i rasteve është ne rënie dhe grupmoshat < 2 vjeç vazhdon te jete grupmosha me e prekur. Kjo për shkak edhe te mosvaksinimit dhe kontaktit apo vizitës te mëparshëm te tyre ne shërbimin pediatrik QSUT. Te gjitha rastet janë konfirmuar ne Laboratorin e Virologjisë, ne ISHP.

## 2.2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit Maj 2019 janë raportuar 34 raste me Tuberkuloz pulmonar. Rastet e raportuara me tuberkuloz pulmonar janë përkatësisht 22 nga Tirana, 3 nga Durrësi, 2 nga Bulqiza, 2 nga Kukësi, 2 nga Lushnja dhe përkatësisht nga një rast kanë raportuar Elbasani, Lezha, dhe Dibër. Rastet janë të grup-moshave te ndryshme nga 15 - 65 + vjeç.

### 3. Zoonozat

Gjatë muajit maj 2019 me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh janë raportuar nga NJVKSH ne nivel vendi kater raste me bruceloze dhe tre raste janë te konfirmuar. Rastet janë raportuar nga rrethi Bulqize (2 raste) dhe përkatësisht nga një rast Lushnje dhe Sarande.

Gjate muajit maj 2019 janë raportuar: kater raste te dyshuar me antraks nga rrethet Mat (2 raste) dhe perkatesisht nga nje rast Tirana dhe Vlora.

Gjate muajit maj janë raportuar dy raste te konfirmuara me Leptospiroze nga Tirana dhe Vlora.

**Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike ne Maj 2019**

(Incidenca raste/100.000 banore)	Raste, Maj 2019	Incidenca Maj 2019 (raste/100.000 banore)
Antraks (Plasje)	4	0.14
Brucelozë	4	0.14
Leptospirozë	2	0.071
Leishmaniaza viscerale	0	0
Leishmaniaza kutane	0	0

### 4. Hepatitet virale

Ne raportimin mujor te sëmundshmërisë infektive gjate muajit maj 2019 janë raportuar ne total 28 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.99/100.000 banore) nga te cilat 5 raste janë Hepatite virale të paspecificuar, 18 raste Hepatit virale B te konfirmuara, 2 Hepatite Virale A te dyshuar dhe 3 raste te konfirmuara me Hepatit viral as A as B.

Ne lidhje me HBV, 18 rastet e konfirmuara janë raportuar përkatësisht nga rrethi Tirane (0.19/10.000 banore), Vlora (0.079/10.000 banore), Peqini (0.38/10.000 banore), Fieri (0.06/10.000 banore), Lushnjë (0.084/10.000 banore) dhe Diber (0.16/10.000 banore). Rastet me Hepatit viral B i përkasin grupmoshës se rritur. Ne lidhje me Hepatitin C janë tre raste te reja te konfirmuara, meshkuj, grupmosha 55-59 vjeç dhe 65+ vjeç nga Lushnja.

Duhet te theksojmë qe laboratorët nuk raportojnë ne lidhje me testimet për Hepatitin B.

### 5. HIV/AIDS

Gjatë muajit Maj 2019 janë kryer 65 ekzaminime me testin ELISA HIV 1+2 Ag/Ab. Nga këto testime, 8 prej tyre kanë rezultuar HIV pozitive. Shpërndarja sipas gjinisë e rasteve pozitive është 6 meshkuj dhe 2 femra. Shpërndarja gjeografike e tyre tregon se 5 raste i përkasin vendbanimit Tiranë, 2 Lezhë dhe 1 Durrës. Shpërndarja sipas grupmoshave është 20-52 vjeç.

Grupmoshat më të prekura në muajin Maj janë 50-54 vjeç (3 raste) dhe grupmosha 35-39 vjeç (2 raste), ndërsa grupmosha 45-49 me 1 rast , grupmosha 40-44 vjeç me 1 rast dhe grupmosha 20-24 vjeç me 1 rast.

Mostrat e rasteve pozitive janë referuar nga këto institucione: 2 raste nga infektivi QSUT; 2 raste nga laborator i mikrobiologjik i DRSH-së Lezhe; 1 raste nga laborator i mikrobiologjik i DRSH-së Tiranë; 1 raste nga QKTGJ; 1 rast nga Burgu 313 dhe 1 rast nga laborator privat.

INSTITUTI I  
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI